

Republika e Shqiperise
Komisioni i Letrave me Vlere

Raporti Vjetor

2004

Annual Report

Albanian Securities Commission
Republic of Albania

Republika e Shqiperise
Komisioni i Letrave me Vlere

RAPORTI VJETOR

2004

Permbajtja e Lendes

Informacion i Pergjithshem mbi Komisionin e Letrave me Vlere Struktura Organizative e Komisionit te Letrave me Vlere

Legjislacioni

Aktiviteti i Licensimit dhe Monitorimit

Licensimi i Tregtareve te Letrave me Vlere

Licensimi i Tregut Letrave Vlere

Licensimi Regjistrit Letrave me Vlere

Monitorimi

Zhvillimi i Tregut

Bashkepunimi Nderkombetar

Bashkepunimi me IOSCO

Marreveshjet e Mirekuptimit

Bashkepunimi ne Seminare dhe Konferenca

Trainime

Aktiviteti Publikues

Projekte per te Ardhmen

Buxheti i KLV ne vitin 2004

Shtojca

Lista e Subjekteve te Licensuara nga Komisioni

Lista E Paketës Ligjore

Informacion i Pergjithshem mbi KLV

Komisioni i Letrave me Vlere (KLV) i Republikes se Shqiperise, eshte krijuar ne baze te Ligjit nr. 8080, date 1.3.1996 "Per Letrat me Vlere", ndjekur nga Vendimi i Keshillit te Ministrave nr. 696, date 14.10.1996.

Komisioni ka funksionet e mëposhtme:

*(a) licencon, vëzhgon dhe mbikëqyr veprimtarinë e tregjeve të letrave me vlerë, si dhe të ofruesve të shërbimeve të pastrimit dhe të rregullimit të transaksioneve të letrave me vlerë, të depozitarëve të letrave me vlerë; **

*(b) licencon, mbikëqyr dhe vëzhgon veprimtaritë e tregtarëve, këshilltarëve të investimeve, përfaqësuesve të tyre përkatës, drejtuesve të investimeve, fondeve të letrave me vlerë të licencuar; **

*(c) miraton statutin dhe rregullat e shoqërive të licencuara për të vepruar si treg i letrave me vlerë ose për të kryer shërbime të pastrimit dhe të rregullimit të transaksioneve të letrave me vlerë, depozitarëve e regjistruarve të letrave me vlerë, si dhe të fondeve të letrave me vlerë; **

(ç) vëzhgon dhe vendos rregullat për drejtimin e të licencuarve, duke përfshirë revokimin dhe pezullimin e licencave;

(d) nxit dhe inkurajon standarde të larta për mbrojtjen e investitorëve dhe integritetin ndërmjet të licencuarve;

(dh) mbështet funksionimin e tregut të letrave me vlerë në mënyrë të rregullt, të hapur dhe të informuar siç duhet;

(e) ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të mbrojtur interesat e investitorëve dhe ndalon veprimet e paligjshme, të pandershme dhe të papërshtatshme lidhur me tregtimin e letrave me vlerë;

(ë) ushtron dhe përmbush të drejta dhe detyra të tilla që i akordohen apo vendosen mbi të;

(f) miraton, ndryshon, pezullon dhe shfuqizon rregulla dhe urdhra të tillë siç autorizohen, ose si të përshtatshme për t'u plotësuar nga ky ligj dhe mund të përcaktojë termat e përdorura në këtë ligj në mënyrë që të përputhen me aktet e tij. Ai ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar përputhjen e këtij ligji me çdo rregull të vendosur në bazë të tij;

(g) mbikëqyr mënyrën e tregimit dhe llojin e letrave me vlerë që tregtohen në tregun përkatës dhe miraton rregullat e tregut të letrave me vlerë lidhur me anëtarësinë, listimin, pjesëmarrjen minimale, mjaftueshmërinë e kapitalit, shpalljet, raportimet periodike, raportimet për të gjithë transaksionet si dhe pastrimin e llogarive e rregullimin e transaksioneve.

KLV eshte autoriteti i vetem rregullator i Tregut te Letrave me Vlere qe zhvillon veprimtarine e tij ne territorin e Shqiperise.


KLV perbehet nga shtate Komisionere te cilet miratohen te Kuvendit Popullor. KLV mblidhet ne takime te rregullta, ku merren vendime, percaktohen prioritete, diskutohet per programet.

KLV financohet nga Buxheti i Shtetit me subvencion per nje periudhe kohe derisa te funksionojë si institucion i pavarur ku pagimi i kuotave dhe detyrimeve te tjera ndaj KLV do te jene te mjaftueshme per funksionimin e tij.

Per permbushjen e misionit te ngarkuar me ligj, KLV ka ngritur administraten e tij, e cila eshte e detyruar te zbatoje te gjitha vendimet e marra dhe detyrat e caktuara ne mbledhjet e Komisionit. Organet drejtuese te administrates jane Bordi i Komisionereve dhe Drejtori Ekzekutiv i KLV.

KLV ndjek nje politike punesimi te kujdesshme e te qendrueshme. Kjo behet permes zgjedhjes se personelit bazuar ne cilesite profesionale, kualifikimeve dhe eksperiences se tyre

Struktura Organizative e Komisionit te Letrave me Vlere



Departamenti i Licensimit dhe Monitorimit

Divizioni i Liçencimit

Ky Divizion perbehet nga dy sektore, Sektori i Licensimit dhe Sektori i mbikqyrjes se te Licensuarve.

Sektori i Licensimit ka këto detyra kryesore:

- ◆ Shqyrton kërkesat për liçencim të paraqitura nga subjektet e ndryshme.
- ◆ Mbikqyr veprimtarinë e të liçencuarve duke marrë në konsideratë gjendjen financiare, kontrollin e brendshëm, shkallën e cilësisë së veprimtarisë si dhe aftësinë profesionale të personelit të punësuar e atë të trupit drejtues.
- ◆ Mban regjistrin e shoqërive të liçencuara, subjektet apo përfaqësuesit e tyre.
- ◆ Bashkëpunon me divizionet e tjera, sidomos me atë të të Mbikqyrjes dhe Disiplinimit, kur zbulon se ka shkelje të dispozitave ligjore dhe kërkon hetime të mëtejshme.

Sektori i Mbikqyrjes se te Licensuarve

Mbikqyr veprimtarinë e personave te licensuar dhe veprimtarinë e ndermjetesve te licensuar duke siguruar perputhjen me dispozitat ligjore ne fuqi. Gjithashtu ky seksion mbikqyr veprimtarinë e institucioneve qe kryejne pastrimin dhe rregullimin e llogarive. Detyrat kryesore te ketij sektori jane:

- ◆ Shqyrton raportet financiare te pergatitura nga ndermjetesit, kontrollon nese regjistrimet jane bere ne perputhje me dispozitat ligjore, ndersa për shtepite e brokerimit kontrollon nese parate e klientit mbahen ne perputhje me rregullat e hartuara nga Komisioni.
- ◆ Shqyrton dhe administron te gjitha kerkesat e bera nga te licensuarit lidhur me nderprerjen e veprimtarise, ndryshimin e objektit te veprimtarise per te cilen eshte licensuar, zgjerimin e ketij objekti etj.
- ◆ Harton raporte periodike ne lidhje me gjendjen financiare te shtepive te brokerimit me qellim mbrojtjen e investitoreve nga ndonje falimentim i mundshem.
- ◆ Trajton ankesat e investitoreve kundrejt personave te licensuar me synim mbrojtjen e interesave te investitoreve.

Divizioni i Monitorimit

Divizioni i Monitorimit te Shoqërive Tregtare siguron qe kerkesat për listimin dhe publikimin te ndiqen nga te gjitha shoqerite ne perputhje me funksionet e mëposhtme:

- ◆ Siguron një ekspozim të plotë të informacionit të nevojshëm që ndikon tregtimin e letrave me vlerë të ofruara apo të tregtuara.
- ◆ Siguron trajtim të drejtë dhe të barabartë të zotëruesve të aksioneve.

- ◆ Ndhomon në zhvillimin e një tregu kapitalesh eficient dhe efektiv si për instrumentat e borxhit, ashtu dhe ato të kapitalit.
- ◆ Harton strategjitë dhe rregulloret në përputhje me tendencat vendase dhe ato të tregut të huaj

Departamenti I Mbikqyrjes dhe Disiplinimit

Divizioni i Mbikqyrjes së Tregut

Misioni i këtij divizioni është mbikqyrja dhe nxitja e zhvillimit të tregut të kapitaleve, duke përfshirë edhe sistemet dhe mekanizmat për pastrimin dhe rregullimin e llogarive dhe transaksioneve. Divizioni ka këto detyra kryesore:

- ◆ Mbikqyrja e aktivitetit të tregtimit në tregun e letrave me vlerë, rregullimi i transaksioneve dhe pastrimi llogarive.
- ◆ Te rishikojë rregulloret dhe procedurat e Bursave si dhe sistemet e tyre për pastrimin dhe rregullimin e llogarive dhe transaksioneve, për të siguruar që keto rregullore dhe procedura janë të pershtatshme, të drejta, të arsyeshme dhe të zbatueshme si dhe që masat ndershkuese të marra sigurojnë mosperseritjen e shkeljeve
- ◆ Te monitorojë sistemet e tregtimit në lidhje me divizionet e tjera perkatese të KLV me qëllim identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve potenciale të cilat mund të ndikojnë për keq në mbarevajtjen e tregut ose që demtojnë publikun investues
- ◆ Pergatitja e raporteve periodike të tregut. Periodiciteti i këtyre raporteve do të percaktohet në varesi të zhvillimit të tregut. Megjithatë raporti i tregut duhet të përgatitet të pakten një herë në muaj. Raporti duhet të përmbajë të dhëna për ndryshimet e cmimeve, volumet e tregtimit dhe të dhëna të tjera që do konsiderohen si të pershtatshme për tu përfshirë në raport
- ◆ Promovimi dhe zhvillimi i një sistemi vetrregullues si dhe i tregut të drejtë.

Divizioni i Disiplinimit

Roli kryesor i Divizionit të Disiplinimit është kontrolli i zbatimit të legjislacionit të tregut të letrave me vlerë si dhe shqyrtimi i rasteve në të cilat është vepruar në kundërshtim me këtë legjislacion. Ky Divizion ka për detyrë:

- ◆ Te hetojë tregtimet e dyshimta në aktivitetin e letrave me vlerë.
- ◆ Te sigurojë përputhshmërinë me Ligjin dhe rregulloret.
- ◆ Te propozojë masa disiplinore dhe u jep organeve përkatëse informacionet e nevojshme për investigime të mëtejshme në rast shkelje të Ligjit.
- ◆ Te shërbejë për mbarëvajtjen e marrëdhënieve me publikun dhe vlerësimin e ankesave të investitorëve.

Departamenti I Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe me Publikun, Strategji Studime

Roli i këtij sektori është ndjekja e raporteve të përditshme të KLV me organizmat ndërkombëtare si dhe vendosja e ndjekja e marrëdhënieve dypalëshe me institucione të tjera rregullatore të tregut të kapitaleve. Ky sektor synon gjithashtu të prezantojë, të promovojë imazhin e KLV si brenda ashtu edhe jashtë vendit si institucioni rregullator i tregut të letrave me vlerë në Shqipëri, si dhe prezantimi dhe promovimi brenda vendit i tregut të letrave me vlerë.

- ◆ Siguron koordinimin e punës së Komisionit me Institucionet e vendeve të tjera që veprojnë si rregullatore të tregut të kapitaleve, me synim përpunimin e parimeve të drejtimit dhe rregullimit të tregut të kapitaleve, si dhe për shkëmbimin e informacioneve të nevojshme;
- ◆ krijimi, forcimi i marrëdhënieve ndërkombëtare të KLV, ku rendesi i vecantë i kushtohet zhvillimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit me IOSCO-n, organizatën ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë
- ◆ siguron koordinimin e punës me donatorët dhe asistentët e huaj
- ◆ Prezantimi, zhvillimi dhe promovimi i imazhit të KLV, në Shqipëri dhe jashtë saj
- ◆ Përcjellja e besimit tek investitorët për sigurimin e sistemit rregullator të tregut të letrave me vlerë në Shqipëri
- ◆ Përgatitja e prezantimeve të ndryshme për Komisionin.
- ◆ Perfaqësimi i KLV në Media.

Sektori i Strategjise dhe Studimit

Roli i këtij sektori qëndron tek hartimi i strategjive afatmesme dhe afatgjata të punës së Komisionit si dhe të bëjë të njohur në Komision zhvillimet e fundit lidhur me direktivat e KE si dhe legjislacionin mbi letrat me vlerë. Përgjegjësitë e këtij sektori janë:

- ◆ Të hartojë strategjitë të zhvillimit në formë programesh njëvjeçare dhe afatmesme të veprimtarisë së Komisionit
- ◆ Të përgatisë materiale studimore dhe edukative lidhur me rendesinë e investimit në letrat me vlerë, rendesinë e ekzistencës së tregjeve të rregulluara etj.

Sekretariati dhe Zyra Juridike

Perbehet nga Sektori Juridik dhe Sekretariati. Detyrat e këtij sektori janë:

- ◆ Sektori juridik keshillon juridikisht Komisionin dhe siguron shërbimet e këshillimit ligjor të tij, qoftë nëpërmjet burimeve të brendshme, ashtu edhe përmes specialistëve të huaj apo të jashtëm,
- ◆ në bashkëpunim me Departamentet e tjera, përgatit, harton dhe përpunon bazën ligjore të funksionimit të Komisionit dhe ja paraqet për miratim Komisionit,

- ◆ pergatit dhe kontrollon dokumentacionin e pergatitur nga Departamentet e tjera e qe vihet ne dispozicion te mbledhjeve te Komisionit apo te Komiteteve
- ◆ ndjek zhvillimin dhe ndryshimet e Direktivave te Komunitetit European me qellim te pershtatjes se kuadrit ligjor te Komisionit me keto Direktiva.
- ◆ Sekretariati sherben në organizimin e mbledhjeve dhe te Komisionit dhe te Komiteteve, ndjek zbatimin e rregullores ne procedurat e thirrjes dhe zhvillimit te mbledhjeve
- ◆ ndjek zbatimin e procedurave te mbajtjes dhe arshivimit se dokumentacionit dhe te vendimeve te mbledhjeve etj.
- ◆ sherben ne zbardhjen e proces-verbaleve te mbledhjeve dhe te vendimeve perkatese, ne bashkepunim me sektorin juridik.

Legjislacioni

Plotesimi dhe permiresimi i kuadrit ligjor te tregut te letrave me vlere ne perputhje me standartet nderkombetare, ka qene fokusi kryesor i aktivitetit te KLV. Ne mbeshtetje te ketij objektivi kane sherbyer parimet e IOSCOs, Direktivat e Komunitetit Evropian dhe eksperiencia e tregjeve me te zhvilluara te letrave me vlere.

Tregu i letrave me vlere ne Shqiperi rregullohet nga Ligji nr. 8080, date 1.3.1996 "Per Letrat me Vlere", ndryshuar me Ligjin nr. 8168 date 5.12.1996 dhe me Ligjin Nr. 8745 date 22.02.2001. Ligji percakton llojet e letrave me vlere, menyren e emetimit te tyre, organizimin dhe veprimtarine e tregut te letrave me vlere, licensimin dhe etiken e subjekteve qe merren me veprimtari te investimit ne letrat me vlere, si dhe statusin dhe autoritetin e Komisionit te Letrave me Vlere.

Pavaresisht nga zhvillimet e tregut te letrave me vlere, edhe gjate vitit 2004, puna e Komisionit eshte fokusuar ne plotesimin dhe permiresimin e kuadrit ligjor te tregut te letrave me vlere ne perputhje me standartet nderkombetare. Nisur nga ky objektivi, vemendja eshte perqendruar ne disa drejtime:

- Nevoja per permiresim te metejshem te Ligjit "Per letrat me vlere", qe lidhet kryesisht me punen per rregullim:
 - te kerkesave per kapital fillestar dhe mjaftueshmeri kapitali te subjekteve qe licensohen,
 - te autoritetit mbikqyres te Komisionit mbi tregun dhe pjesmarresit e tij
 - te autoritetit te Komisionit mbi qeverisjen e shoqerive aksionere.
- Hartimi i rregullave mbi praktikaten e paligjshme te tregtimit. Mbeshtetur ne Direktiven e KE 2003/6/EC mbi abuzimet e tregut, keto rregulla pritet te miratohen brenda vitit 2005. Ato synojne te plotesojne me qarte dhe ne detaje Kreun e VIII te Ligjit "Per letrat me vlere" Praktikaten e paligjshme te tregtimit.
- Rishikimi dhe miratimi i Rregullave te Burses se Tiranes dhe Qendres se Rregjistrimit te Aksioneve.

Mbeshtetur ne Ligjin "Per letrat me vlere" Komisioni miraton rregullat e shoqerive te licensuara per te vepruar si treg letrash me vlere dhe shoqerive qe ofrojne sherbimin e rregjistrimit te letrave me vlere.

Ne dhjetor 2004, Komisioni miratoi dy rregulloret e Qendres se Rregjistrimit te Aksioneve: Rregullore mbi kryerjen e sherbimeve nga QRA dhe Rregullore mbi reflektimin e transaksioneve nga QRA.

Bursa e Tiranes i paraqiti Komisionit disa ndryshime ne Rregulloret e saj te Tregtimit, Listimit dhe Antaresimit, te rekomanduara nga ekspertet e huaj.

Licensimi dhe Monitorimi

Objektivi i Komisionit te Letrave me Vlere ne aktivitetin e licensimit dhe monitorimit eshte sigurimi i nje tregu te drejte dhe te rregulluar nepermjet licensimit te te gjithe pjesmarresve ne treg, monitorimit te tyre dhe sigurimit ne cdo kohe qe keta pjesmarres plotesojne kerkesat fillestare dhe ato ne vazhdim ne perputhje me dispozitat ne fuqi.

Politikat e licensimit te Komisionit synojne ne trajtimin e paanshem, te drejte, te barabarte dhe transparent te te gjithe aplikuesve per license.

Licensimi iTregtareve teLetrave me Vlere

Ne perputhje me Rregulloren Nr.2/2, date 07.02.2003 "Mbi licensimin e tregtarit te letrave me vlere dhe perfaqesuesit te tij", e cila percakton proceduren, kerkesat dhe kushtet per licensimin e tregtarit te letrave me vlere dhe perfaqesuesit te tij, Komisioni jep license tregtimi shoqerise aksionere dhe perfaqesuesit te tij, kur kerkuesi i licenses permbush kushtet per te zhvilluar kete aktivitet.

Licensa percakton llojin e veprimtarise qe do te ushtrohet, llojin e letres me vlere qe do te tregtohet, vendin ku do ushtrohet aktiviteti dhe afatin brenda te cilit eshte i vlefshme kjo license.

Lidhur me afatin e vlefshmerise se licenses, gjate dy viteve te fundit eshte ndjekur praktika e ofrimit te licensave pa afat, krahas atyre me afat me te drejte rinovimi.

Gjate vitit 2004, kane patur te vlefshme licensen 9 subjekte, nga te cilat:

- 4 subjekte license pa afat,
- 4 subjekte license me afat nje vjecar me te drejte rinovimi,
- 1 subjekt license me afat 6-muaj.

Nderkohe, gjate vitit 2004, Komisioni ka marre ne konsiderate nje kerkese per rinovim license tregtari, por pa afat, e cila eshte miratuar ne permbushje te kerkesave per dhenie license.

Nga 10 subjektet e mesiperme te pajisura me license tregtari, 7 subjekte jane banka.

Tabele Shoqerite aksionere me license tregtari per vitin 2004

Nr.	Emertimi i shoqerise aksionere	Nr. i perfaq	Afati i licenses
1.	Banka Credins	1	Pa afat
2.	Banka Raiffeisen	1	Pa afat
3.	Banka Tirana	1	Pa afat
4.	Ballkan Group-01	3	Pa afat
5.	Triumpf Group	1	Pa afat
6.	Banka Amerikane e Shqiperise	2	1 vit
7.	Banka Italo-Shqiptare	2	1 vit
8.	Banka Kombetare Tregtare	2	1 vit
9.	Banka Procredit	1	1 vit
10.	Action Capital	1	6-muaj

Bursa e Tiranës u hap zyrtarisht në 2 Maj 1996, dhe funksionoi deri në vitin 2002 si Departament i Bankës së Shqipërisë. Si pjesë e aktivitetit të saj, Bursa e Tiranës kishte edhe organizimin e tregut primar dhe sekondar të Bonove të Thesarit

Licensimi i Tregut të Letrave me Vlerë

Me shqepëtimin e Bursës së Tiranës nga Banka e Shqipërisë dhe krijimin si ent me vete, Komisioni i Letrave me vlerë licensoi shoqëri anonime “Bursa e Tiranës” me datën 01.07.2003 dhe numer licensë 66, për të operuar si treg letrash me vlerë.

Gjykuar nga kushtet aktuale të zhvillimit të tregut, licensa është me afat dy vjet me të drejtë rinovimi.

Bursa e Tiranës mbetet i vetmi treg letrash me vlerë që ofron një platformë emetimi, tregtimi, pastrimi dhe rregullimi të llogarive, si dhe shërbime të tjera të tregut për emetuesit potenciale.

Licensimi i Rregjistruesve të Letrave me Vlerë

Shoqëria anonime me kapital shtetëror “Qendra e Rregjistrimit të Aksioneve” mban licensën nr.58, licensuar nga KLV me datën 05.11.2002. Aktualisht, ajo përfaqëson të vetmen shoqëri të licensuar për ofrimin e shërbimit të rregjistrimit të aksioneve, nëpërmjet mbajtjes së rregjistrimit, duke siguruar në çdo kohë të dhëna të plota mbi pronësinë e aksioneve.

Në fund të vitit 2004 rezultojnë të regjistruara në Qendren e Rregjistrimit të Aksioneve 61 shoqëri anonime. Numri i aksioneve të transferuara për periudhën vjetore (të reflektuara në regjistrat e aksioneve të shoqërive të mesipërme) është 873.053 aksione.

Ndërsa numri i transaksioneve të reflektuara në regjistrat e aksioneve gjatë periudhës së mesipërme është 1307, me një rritje të lehtë ndaj transaksioneve të kryera gjatë vitit 2003. Këto transaksione janë kryer ndërmjet shitësit dhe blerësit jashtë tregut dhe pa shërbimin operatorëve të tregut.

Gjatë vitit 2004, Ministria e Ekonomisë ndërmori hapa për privatizimin e shoqërisë “Qendra e Rregjistrimit të Aksioneve”. Privatizimi i këtij enti kërkon përcaktimin e disa kriterëve baze që kanë të bëjnë me: vazhdimësinë e aktivitetit të kësaj shoqërie, me përmirësimin e teknologjisë së informacionit, forcimin e besueshmërisë së këtij institucioni.

Gjatë vitit 2004 u paraqitën edhe 2 kërkesa të reja për licensën “Rregjistrues i letrave me vlerë”.

Regjistri i aksioneve

Shoqëritë anonime me mbi 50 aksionere kanë detyrimin ligjor për mbajtjen e regjistratit të aksioneve të tyre pranë një Qendre të pavarur Rregjistrimi. Rregjistruesi i aksioneve krahas mbajtjes së regjistratit, me kryerjen e transaksioneve, ben edhe azhormimin e tij. Rregjistruesi ofron edhe shërbime të tjera si:

- njoftimi i mbledhjes së pergjithshme të asamblese së aksionereve*
- llogaritja e dividendit*
- konfirmimi i llogarise së aksionerit, etj*

Monitorimi

Monitorimi i subjekteve të licensuara synon përputhshmërinë e veprimtarisë së tyre me dispozitat ligjore në fuqi për të krijuar sigurinë së praktikave të ndjekura dhe aktiviteti investues në letra me vlerë janë të drejta, të arsyeshme dhe në interes të publikut.

Subjektet e licensuara raportojnë periodikisht pranë Komisionit të Letrave me Vlerë, nëpërmjet raporteve mujore, gjashtëmujore dhe vjetore.

Komisioni, në çdo rast mund t’i kërkojë të liçencuarit, informacion të pergjithshëm ose të dhëna për çështje të veçanta të lidhura me aktivitetin e tij.

Zhvillimi e Tregut

Komisioni me licensimin e Burses se Tiranes (BT), si ent i pavarur, per te operuar si treg letrash me vlere, miratoi edhe produktet e mundshme qe tregtohen ne kete treg si: aksione, obligacione, letra me vlere te qeverise.

BT vazhdon t'i mungoje produkti baze: aksionet. Deri ne fund te vitit 2004, asnje shoqeri nuk ka listuar letrat e veta ne kete treg.

Problemet e fillimit te aktivitetit te tregut dhe veshtiresite qe hasen per nje ecuri te mbare te ketij procesi jane bere shpesh here objekt diskutimi dhe debatesh.

Konkluzionet e dala nga takimet e debatet mes specialisteve shqiptare, te asistuar edhe nga ekspertet e huaj gjate viteve te fundit jane:
-Ne Shqiperi ekzistojne kushtet per zhvillimin e tregut te letrave me vlere;
-Opsioni me optimal i zhvillimit te tregut te letrave me vlere ne Shqiperi eshte opsioni i zhvillimit te Burses se Tiranes, si nje platforme multifunksionale tregtimi per instrumente te tregut te parase dhe te kapitaleve;
-Zhvillimi i tregut te brendshem te letrave me vlere do te kontribuojte ne zhvillimin me te shpejte ekonomik te vendit;

Viti 2004 shenoi perfundimin e punes per hartimin e Projektstrategjise se zhvillimit te BT si treg letrash me vlere, nga stafi i BT ne mbeshtetje te Raportit te eksperteve te GMA Capital Markets Limited, financiar nga Banka Boterore. Kjo Projektstrategji perfaqeson dokumentin baze dhe planin e veprimeve per zhvillimet e ardhshme te Tregut te Letrave me Vlere ne Shqiperi. Dokumenti permban dy momente te rendesishme:

- 1) venien ne funksionim te BT, duke e shnderruar ate ne nje treg real,
- 2) modelimin e BT sipas standarteve nderkombetare dhe parimeve te biznesit.

Mbeshtetur ne historine e zhvillimit te sistemit financiar shqiptar, ecurine ekonomike te periudhes se tranzicionit, kushtet aktuale te ambientit ekonomik, politik e social ne vend, Projektstrategjia percakton fushat e mundshme te shtrirjes se aktivitetit te Burses se Tiranes.

Rruget e mundshme te zhvillimit te saj jane:

- organizimi i tregut primar te letrave me vlere te qeverise me afat maturimi 12 mujor e lart,
- dhe i tregut sekondar i letrave te qeverise,
 - tregu i aksioneve te shoqerive shtetore dhe atyre private,
 - tregu i obligacioneve te shoqerive, etj.

Prioritet mbetet tregu i aksioneve, si nepermjet realizimit ne Burse te programeve te privatizimit te aksioneve ne pronesi te shtetit, ashtu dhe nepermjet listimit te shoqerive private nepermjet ofertave publike. Tregu behet realisht aktiv me tregtimin e aksioneve te pakten te 3-4 listimeve te ndryshme. Obligacionet mbeten nje produkt i rendesishem, por jo te vetmit per te prezantuar nje Burse aktive.


Permbushja e hapave te percaktuara ne projektstrategji eshte e lidhur ngushte me angazhimet e Qeverise dhe marrjen e masave konkrete per sigurimin e ambientit te nevojshem dhe teknologjise se tregtimit si nevojte e domosdoshme per funksionimin e Burses. Roli i qeverise konsiston, vecanerisht, ne sigurimin e paketes se pare te letrave me vlere duke nxitur fillimin e tregtimit, per te provuar ne kete menyre kapacitetin operacional te Burses se Tiranes dhe ne te njejeten kohe per te rritur besimin e shoqerive emetuese dhe te publikut investues.

Kkohet e fundit po ndihet nje interesim, nga ana e biznesit privat, lidhur me shfrytezimin e burses si alternativë e mundshme për thithjen e fondeve të nevojshme për zgjerimin e aktivitetit të tyre ekonomik. Ezaurimi i kapaciteteve kredimarrëse të bankave nga ana e bizneseve të madhenj, pashmangshmërisht do të konsiderojnë shumë shpejt opsionin e përdorimit të alternativës së bursës për financim. Nga ana tjetër, rritja e konsiderueshme e importeve për makineri dhe pajisje, është një tregues i qartë i orientimit të biznesit shqiptar drejt investimeve prodhuese dhe në vlera të konsiderueshme, të cilat do të kërkojnë aktivizimin e ofertes publike. Megjithatë biznesi privat dëshiron dhe është i interesuar të shohë një treg kapitalesh në zhvillim e sipër e që mund t'u sigurojë atyre burime alternative financimi, mendohet se biznesi privat nuk do të jetë i pari që do t'i afrohet BURSES.

Marre nga Strategjia e Zhvillimit te BT

Bilanci I Kursim Investimeve shpreh nivelin e investimeve ne ekonomi te pambuluara nga kursimet e brendshme. Bilanci I Kursim Investimeve, i pare ne vite, ka shenuar nje permiresim te lehte nga 7% ne 2002, ne 5.6% ne 2003 dhe ne 5% ne 2004, duke ulur keshtu deficitin korrent. Ky permiresim eshte si rezultat i rritjes me te larte te kursimeve se sa ajo e investimeve. Megjithate kusimet vazhdojne te zene nje perqindje ndaj PBB-se, me te vogel se sa investimet. Ne totalin e kursimeve, dominojne ato private rreth 98.5%.

Grafiku: Bilanci i kursim-investimeve



	2000	2001	2002	2003	2004
■ Kursime (ne % e PBB-se)	20.3	25.9	19.2	19.4	20.4
■ Investime (ne % e PBB-se)	24.7	29.2	26.2	25	25.4

Financimi bankar nepermjet blerjeve te Bonove te Thesarit dhe obligacioneve 2 vjecare, ka mbajtur peshen me te madhe te financimit te brendshem te I deficitit buxhetor.


Bankat e nivelit te dyte dhe individet kane rritur portofolet e bonove te thesarit

V.2004 ka shenuar rritje te numrit te transaksioneve nderbankare me afat me te gjate maturimi. Sistemi banker ka rritue interesin ne investimin e obligacioneve. Pesha e obligacioneve ne portofolin e letrave me vlere ne sistemin banker ehste rritur nga 2.4% ne 2003 , ne 6.1% ne 2004, ndersa ajo e Bth 3-m eshte ulur nga 9.2% ne 2.8%.

Oferta e bankave per te investuar ne Bono Thesari ka qene me e madhe se shuma e emetuar ne tregun primar, duke ushtruar presione ne uljen e yield-it.

. v. 2004 ato arriten nivelet me te ulta historike, ndersa yield-I I obligacioneve ka rene ne magnitudo me te vogel se sa yield-et e tjera, nga 10.2% ne 9%.

Gjate v. 2004 jane emetuar 8.5 miliarde leke obligacione qeveritar



		2002	2003	2004
Kredia per Ekonomine	ne% te M3	9.3	11.3	16.9
Kredia per Qeverine	ne% te M3	61.5	60.2	55.1
Kredia per Ekonomine	ne% te PBB	5.7	6.8	8.4
Depozita gjithesej	ne% te PBB	42.2	43.4	44.1
Raporti kredi/depozita	ne%	13.5	15.7	19

Bashkepunimi Nderkombetar

Komisioni, gjate vitit 2004 ka vazhduar punen e tij ne drejtim te forcimit te marrredhenieve me institucionet nderkombetare te tregjeve te kapitalit me qellim lehtesimin e shkembimit te informacionit si dhe mbrojtjes se investimeve.

Gjate ketij viti bashkerendimi i punes se Komisionit me autoritete te ngjashme te tregut te kapitalit ne bote, i ka sherbyer nxitjes se bashkepunimit per standartet nderkombetare dhe procedurat e tregjeve te kapitalit ne bote.

Bashkepunimi me IOSCO-n

KLV qe prej vitit 1998 eshte anetar i IOSCOs (Organizates Nderkombetare te Komisioneve te Letrave me Vlere) dhe anetar i Komitetit te Tregjeve ne Zhvillim (KTZH) te kesaj organizate. Kjo organizate perbehet nga institucione qe mbikqyrin tregjet e kapitalit ne bote.

Ne driten e ngjarjeve te 11 Shtatorit, ne Tetor 2001 Komitetet Teknike dhe Ekzekutive te IOSCOs vendosen per te krijuar nje grup te vecante pune per te percaktuar hapat qe duhet te ndermarre IOSCO per te permiresuar bashkepunimin dhe shkembimin e informacionit midis anetareve te IOSCOs.

Ky grup pune i fokusoi perpjekjet e tij ne formulimin e nje Marreveshje Mirekuptimi Shumepaleshe (MMOU) e cila vendos norma te reja nderkombetare per bashkepunim qe konsiderohen kritike per te luftuar kunder dhunimeve qe i behen ligjeve te letrave me vlere. Kjo MoU shpreh gjithashtu nje angazhim te anetareve te IOSCOs per te vendosur marrredhenie efektive per shkembimin e informacionit per rastet e perdorimit ilegal te tregjeve te letrave me vlere, perfshire abuzimet ne treg dhe mashtrimet.

Ne Maj 2002, Komiteti i Presidenteve aprovoi MMOU per te lehtesuar dhe thelluar nivelin e zbatimit lidhur me bashkepunimin dhe shkembimin e informacionit ndermjet anetareve te IOSCOs

Deri tani 26 anetare jane pranuar per te firmosur, dhe kater anetare te tjere kane pranuar te zbatojne ndryshimet e kerkuara per te firmosur kete Marreveshje. Me shume se 50 aplikime (pothuaj gjysma e numrit te anetare me te drejta te plota te IOSCOs) kane arritur ne Sekretariatin e Pergjithshem te IOSCOs per te firmosur Marreveshjen.

Gjate vitit 2004, Komisioni ka vazhduar bashkepunimin e tij me IOSCO-n si pjese e strukturave te tij ne lidhje me probleme te ndryshme.

KLV gjate ketij viti ka bashkepunuar me IOSCO-n lidhur me plotesimin e pyetesoreve te ndryshem qe synojne standartizimin e legjislacioneve midis vendeve te ndryshme anetare. Ne Shtator 2004, KLV dorezoi prane Komitetit te Tregjeve ne Zhvillim (KTZH) te IOSCOs pyetesorin e plotesuar lidhur me qeverisjen e shoqerive aksionere. Bordi Keshillues i KTZH ne Shkurt 2004, aprovoi krijimin e nje Task Force qe do te punonte me nje mandat te vecante per ceshtjen e Qeverisjes se Shoqerive Aksionere. Ne vazhdim te diskutimeve qe u mbajten ne mbledhjen plenare te KTZH ne Aman ne Maj 2004, ky grup pune perгатiti draftin e pyetesorit per qeverisjen e shoqerive aksionere me qellim vrojtimin e kuadrit ligjor te vendeve anetare te KTZH ne lidhje me kete ceshtje, per te krijuar kushtet per nje analize me te detajuar ne kete drejtim.

Gjate Shtatorit 2004, KLV ka dorezuar gjithashtu te plotesuar pyetesorin mbi mbikqyrjen e eksperteve kontabel qe u aprovua si mandat per Grupin e Punes nr.1 ne mbledhjen e fundit te ketij grupi ne Aman, te Jordanise ne Maj te po ketij viti.

Komiteti Teknik i Tregjeve dhe Komiteti i Tregjeve ne Zhvillim te IOSCOs ndermoren kete anketim per te mbledhur informacion mbi strukturat dhe proceset e mbikqyrjes per mbikqyrjen e kontabilizimit dhe raportimit financiar per vendet anetare te IOSCOs. Pyetesori eshte perгатitur te identifikojte pergjigjet kombetare dhe/ose rajonale lidhur me deshtimet ne raportimin financiar dhe ndryshimet qe rezultojne ne shpresat e publikut lidhur me kontabilizimin, shkallen ne te cilen

praktikat dhe menytrat e tanishme perqafojne parimet e IOSCOs mbi Mbikqyrjen e Eksperteve Kontabel e Parimet e pavaresise se Eksperteve Kontabel dhe rolin e qeverisjes se Shoqerive Aksionere ne monitorimin e pavaresise se eksperteve kontabel. Pyetesori eshte pergatitur gjithashtu qe te siguroje edhe informacion qe mund te jete I dobishem ne perpjekje per te nxitur rregullimet bashkekohore te mbikqyrjes.

Memorandume Mirekuptimi

Gjate vitit 2004 Komisioni i Letrave me Vlere i Shqiperise ka vazhduar punen per forcimin e lidhjeve te tij me autoritetet aktiviteti i te cilave eshte i lidhur me tregjet e kapitaleve ne bote, duke nxitur ne kete menyre koordinimin, shkembimin e informacionit dhe rritjen e integritimit.

Komisioni i Letrave me Vlere i Shqiperise duke e konsideruar zbatimin e MOU shumepaleshe nje mjet kryesor per nje funksionim te lehte dhe eficient te nje tregu financiar me te madh nderkufitar.ka punuar gjate vitit 2004 per aplikimin per te firmosur kete Marreveshje shumepaleshe te Mirekuptimit te IOSCOs.

Gjate ketij viti eshte punuar dhe jane bere ndryshime mbi projektin e Marreveshjes se Mirekuptimit qe pritet te nenshkruhet me Komisionin Maqedon te Letrave me Vlere gjate vitit te ardhshem.

Gjithashtu ne fund te vitit 2004 filloi puna per pergatitjen e projekt marreveshjes midis Komisionit te Letrave me Vlere dhe Komisionit Kombetar te Letrave me Vlere te Rumanise. Kjo Marreveshje pritet te nenshkruhet ne fillim te vitit te ardhshem.

Ne kuadrin e lidhjeve te Marreveshjeve te Mirekuptimit me institucione brenda vendit, gjate ketij viti u punua per pergatitjen e nje projekt marreveshje midis KLV, Bankes se Shqiperise dhe Komisionit te Mbikqyrjes se Sigurimeve.

Bashkepunimi ne Seminare dhe Konferenca

KLV bashkepunimin me Institucione te tjera brenda vendit e shikon si shkembim te eksperiences dhe rrahjes se mendimeve me keto Autoritete per ceshtje te ndryshme ne lidhje me zhvillimin e tregut te kapitaleve.

- Ne Qershor te 2004 eksperte nga KLV ne bashkepunim me Institutin e Eksperteve Kontabel te Autorizuar moren pjese ne programin e kualifikimit te rradhes te eksperteve kontabel te autorizuar. Ekspertet e KLV drejtuan seancen per problemet e tregut shqiptar te letrave me vlere. Seanca u zhvillua ne formen prezantim-debat, duke nxjerre ne pah edhe rolin e ekspertit kontabel ne auditimin e tregtareve te letrave me vlere dhe shoqerive qe do te listohen ne Burse duke ndikuar ne rritjen e transparences dhe informimin e publikut ne procesin e investimit ne letra me vlere.

- Ne 25 Shkurt 2004 u organizua ne Tirane Konferenca Promovimi me teme: "Qeverisja e shoqerive aksionere ne Europen Juglindore". Ne kete konferenca u promovua Dokumenti (White paper) i OECD mbi qeverisjen e shoqerive aksionere ne Europen Juglindore. Ky dokument, krahas promovimit te parimeve te OECD, identifikon

njekohesisht fushat me te rendesishme, ne te cilat duhet ndermarre reforma per nje mireqeverisje te shoqerive aksionere.

Komisioni i Letrave me Vlere u prezantua ne kete Konferenc me kumtesen "Roli i rregullatorit te letrave me vlere ne rritjen e transparences dhe informimit", duke e vene theksin ne disa probleme kyc qe lidhen me:

- transparencen e aktivitetit te shoqerise
- informimin e vazhdueshem dhe periodik
- kushtet per shperndarjen e informacionit.

Ne perfundim u konkludua per nevojen e angazhimit te te gjitha paleve te interesuara per fillimin e nje procesi qe do te ndikonte ne permiresimin e qeverisjes se shoqerive aksionere.

- Ne Qershor 2004 KLV mori pjese ne mbledhjen rajonale te OECD mbi qeverisjen e shoqerive aksionere. Tema e kesaj mbledhje ishte "Transparenca dhe Dhenia e Informacionit: Zbatimi dhe Mbikqyrja". Mbledhja ishte organizuar nga OECD ne bashkepunim me Ministrine e Ekonomise se Maqedonise dhe Keshillin Maqedon mbi Qeverisjen e Shoqerive Aksionere. Pjesemarrsit diskutuan kryesisht mbi Parimet e OECD mbi Qeverisjen e Shoqerive Aksionere dhe rishikimin e tyre.

Trainime

Gjate vitit 2004 eshte punuar ne vazhdimesi per ndjekjen dhe koordinimin e programeve te trainimit. Stafi i KLV ka marre pjese ne aktivitetet e meposhtme te organizuara nga institucione dhe organizata nderkombetare ne lidhje me tregjet e kapitaleve ne bote:

- Ne Prill 2004, KLV mori pjese ne Seminarin e Trainimit rajonal mbi Direktiven e Abuzimit te Tregut ne Stamboll te Turqise . Seminari u fokusua ne Direktiven e Abuzimit te Tregut te BE ne kushte krahasuese me legjislacionin mbi abuzimin ne tregun e letrave me vlere te SHBA. Gjithashtu Seminari sherbeu si nje platforme e dobishme per shkembimin e informacionit nga eksperte te rendesishem te fushes financiare.
- Ne Prill 2004 KLV mori pjese ne programin e trainimit 2004 te Institutit Nderkombetar per Zhvillimin e Tregjeve te Letrave me Vlere organizuar ne zyrat qendrore te Komisionit te Letrave me Vlere dhe Burses se SHBA ne Washington, D.C. Pjesemarrja ne kete program ishte nje menyre e mire per pjesemarrsit nga rregullatore te ndryshem ne bote te punonin se bashke ne perpjekje per te zhvilluar sisteme te forta rregullatore qe nxisin integritetin e tregjeve te letrave me vlere ne mbare boten.

Aktiviteti Publikues

KLV ka vazhduar te publikoje gjate ketij viti "Periodikun KLV" qe ka dale rregullisht cdo tre muaj ne shqip dhe ne anglisht. Ky Botim ka dhene nje informacion te dobishem mbi veprimtarine e Komisionit dhe mbi zhvillimin e tregut te kapitaleve.

Temat kryesore te periodikut per vitin 2004 kane konsistuar ne:

- *Janar 2004* 20 Vjetori I Krijimit te IOSCOs

- *Prill 2004* SIPC dhe Mbrojtja e Investitoreve

- *Korrik 2004* Zhvillimi I Tregut te Letrave te Borxhit te Qeverise

-*Tetor 2004* Forumi I Perbashket siguron mbikqyrje te aktiviteteve te nenkontraktuara te sektorit financiar

Gjate ketij viti, KLV sipas detyres se ngarkuar me ligj ka publikuar Raportin Vjetor 2003.

Keto botime, kane synuar te pasqyrojne punen e Komisionit ne drejtim te ngritjes se nje baze ligjore bashkekohore si autoritet i vetem rregullator i tregut te letrave me vlere ne vend, bazuar ne parimet e IOSCO-s dhe Direktivat e KE qe kane si qellimin me te larte mbrojtjen e investitoreve, parandalimin e mbi-rregullimit dhe terheqjen e pjesemarresve ne treg.

Projektet per te Ardhmen

Veprimtaria e Komisionit gjatë 2005 do të synojë:

- *Plotësimin dhe permiresimin e kuadrit ligjor për letrat me vlerë*

Synimi i Komisionit është që gjatë 2005 t'i paraqesë për Miratim Parlamentit Projekt - Ligjin "Mbi Investimet Kolektive në Fondet e Letrave me Vlerë" si dhe përgatisë aktet e nevojshme nënligjore.

Per rregullimin ligjor te emetimit dhe tregtimit te obligacioneve te shoqerive, Komisioni synon te pergatise draft-ligjin "Per obligacionet e shoqerive tregtare".

Procedurat e licencimit do të zgjerohen më tej duke përfshirë të gjitha llojet e licencave, që mund të jepen nga Komisioni si dhe kërkesat e sakta për çdo aplikant.

Me kete synim do të vazhdohet të punohet për:

